



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 110, datë 16.12.2024

**PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN APO ZHVLERËSOHEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT TË RIJETËZIMIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “TID” DURRËS, PËR
ZHVILLIMIN DHE RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Akt Marrëveshjes nr.7773/1 prot., datë 02.10.2023 “Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Albanian-American Development Foundation dhe Ministrisë e Kulturës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e projektit TID Durrësi”, Vendimit nr. 07, datë 02.4.2024 të Keshillit Kombëtar të Territorit “Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës”, përcjellë Bashkisë Durrës nga Sekretaria Teknike e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit me shkresë nr.4215/2 prot., datë 05.12.2024 prot., e protokolluar në Bashki me nr. 9073/7, datë 06.12.2024, sipas relacionit të ardhur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e vlerës së shpronësimit për pasuritë e paluajtshme të identifikuara si të domosdoshme për realizimin e projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës”, sipas tabelës dhe relacionit të hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër nr. 310, datë 06.9.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi që do të realizohet në zbatim të Marrëveshjes nr. 7773/1 prot., datë 02.10.2023, lidhur ndërmjet AADF, Ministria Përgjegjëse për Kulturën dhe Bashkisë Durrës”, i ndryshuar me Urdhër nr. 427, datë 08.11.2024, që i bashkëlidhet vendimit dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Fondet për shpronësimin e këtyre pasurive do të alokohen nga Buxheti i Shtetit dhe do të përdoren për të paguar kompensimin e pronarëve të pasurive, që do të shpronësohen.
3. Kompensimi për pasuritë e llojit “Ndërtesë” është bazuar në vlerën e tregut sipas përcaktimit të VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, ndërsa kompensimi për pasurinë e llojit “Truall” është kryer sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 467 227 937 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë shtatë) lekë e përlllogaritur nga grupi i punës, e pasqyruar në dokumentin me emërtimin “Lista emërore paraprake për shpronësimin, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës”, përballohet nga fondet për financimin e projektit të Qeverisë Shqiptare, kjo në zbatim të prioriteteve të Programit të Qeverisë “Shqipëria 2023”, miratuar me Vendim nr. 68/2021 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, Seksioni Kultura për “Përfundimin e Projektit të Rijetëzimit të Amfiteatrit të Durrësit”.
5. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.



Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 17.12.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës, më 06.12.2024



MIRATOHET
KRYETAR
Emiriana Sako

RELACION

MBI ZBATIMIN E URDHËRIT NR. 310, DATË 06.9.2024 “PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VLERËSIMIN PARAPRAK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI QË DO TË REALIZOHET NË ZBATIM TË MARRËVESHJES NR. 7773/1 PROT., DATË 02.10.2023, LIDHUR NDËRMJET AADF, MINISTERIA PËRGJEGJËSE PËR KULTURËN DHE BASHKISË DURRËS, I NDRYSHUAR ME URDHËR NR. 427, DATË 08.11.2024

Referuar Urdhrit nr. 310, datë 06.9.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi që do të realizohet në zbatim të marrëveshjes nr. 7773/1 prot., datë 02.10.2023, lidhur ndërmjet AADF, Ministria Përgjegjëse për Kulturën dhe Bashkisë Durrës”, i ndryshuar me Urdhër nr. 427, datë 08.11.2024, për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës”, grupi i punës i përbërë nga znj. Alneida Rroshi (kryetar), znj. Bianka Madhi, z. Aleks Prenga, z. Alvaro Kaçupi, z. Enli Kaçuli dhe znj. Danjela Gjinika (anëtar), për realizimin e detyrës së ngarkuar është bazuar në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku neni 41 përcakton “... e drejta e pronës është e garantuar; Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interes publik; Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që bazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë; Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë...”.



- Ligji nr. 8561, datë 22.11.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.
- VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM-ja nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive, që zhvlerësohen, dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar

Shkaku i shpronësimit të pasurive pronë private ka të bëjë me realizimin e një projekti dhe investimi në nivel qendror dhe vendor, në funksion të ruajtjes së kulturës, si dhe në shërbim në interes të publikut. Konkretisht, shpronësimi i pasurive që preken nga projekti, kërkohet për arsye se Ministria përgjegjëse për Kulturën (për interes kulture dhe trashëgimi kulturore), në funksion dhe shërbim të qytetarëve të Durrësit, por jo vetëm, do të investojë në rehabilitimin e Amfiteatrit të Durrësit dhe ky investim nuk mund të arrihet pa ushtruar të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme pronë private.

Kjo bazë ligjore ka shërbyer për të përcaktuar pronarët e pronës që kërkohet të shpronësohen, së bashku me të dhënat specifike të vendodhjes së pronës, si dhe vlerën e pasurisë që kërkohet të shpronësohet.


Për zbatimin e detyrës së ngarkuar, grupi i punës u bazua në gjurmën e projektit, e miratuar me leje Zhvillimore nr. 07, datë 02.4.2024 dhe në hartën Asig Gjeoportali, nga ku rezultoi se gjurma e projektit prek 99 pasuri.

Bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.11.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dalë në bazë e për zbatim të ligjit, grupi i punës u përqëndrua në marrjen e informacionit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, për gjendjen juridike të pasurive që preken nga projekti, duke e shoqëruar informacionin me kopje të hartës dhe kartelë pasurie. Korrespondenca me ASHK-në Durrës është kryer nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve pranë Bashkisë Durrës në adresën elektronike e-mail.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës i është përgjigjur kërkesës së Bashkisë Durrës për informacion dhe dokumentacion nëpërmjet sistemit elektronik që mban datën 14.11.2024, duke na bërë me dije informacionin për gjendjen juridike të pasurive të kërkuara, duke e shoqëruar informacionin me kopje të hartës dhe kartelë pasurie.

Për përcaktimin e vlerës së shpronësimit të pasurive të llojit Ndërtesë (Apartament; Njësi; Garazh/Bodrum), grupi i punës është bazuar në informacionin e ardhur në rrugë elektronike nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me anë të së cilës na bëhet me dije çmimi mesatar i tre muajve të fundit të shitblerjeve sipas llojit të pronës të kërkuara nga ana e jonë, bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive, që zhvlerësohen, dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Për vlerësimin e pasurive, pronë private të llojit truall, grupi i punës është bazuar jo në informacionin e marrë nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, por është bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së Vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,



sipas përcaktimit të VKM-së nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar ku për rastin e vlerësimit të pasurisë së llojit truall, përcakton se: “... Vlerësimi për truallin përcaktohet, sipas çmimeve të miratuara, me vendim të Këshillit të Ministrave, për trojet urbane, brenda vijës së verdhë, trojet në qytete dhe komuna, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

Bazuar në VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016, ku ka miratuar hartën e vlerës së tokës ka rezultuar se vlera e tokës së llojit Truall, e ndodhur në ZK 8512 është 19155 lekë/ m², ndërsa vlera e pasurisë po e llojit Truall, e ndodhur në ZK 8514 është 17898 lekë/m². Kjo vlerë ka shërbyer për të llogaritur vlerën e shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga investimi, e llojit Truall. Ndërsa për vlerësimin e pasurive të llojit “Ndërtesë”, ku përfshihen Njësi banimi, jo banimi, Garazh/Bodrum, grupi i punës është bazuar në informacionin e ardhur nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, e përcjellë në rrugë elektronike, që mban datën 14.11.2024, që bën fjalë për çmimin mesatar të shitblerjeve të tre muajve të fundit për pasuritë e llojit Ndërtesë, si një përcaktim që i bën VKM-ja nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, ku pika 2 përcakton se: “...2. Vlerësimi për objektet e banimit të përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, përcaktuar nga ZRPP-ja, sipas procedurës për rastin e truallit...”.

Edhe ky informacion i ardhur nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës ka shërbyer për përcaktimin e vlerës të pasurisë ndërtesë me funksion banimi; ndërtesë me funksion jo banimi, Garazh/Bodrum.

Referuar informacionit të ardhur në rrugë elektronike që mban datën 14.11.2024 nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës rezulton se çmimi mesatar i shitblerjeve për periudhën e tre muajve të fundit (01 Gusht 2024 deri me 01 Nëntor 2024) për llojin e pasurisë Apartament të ndodhur në ZK 8512 vlera mesatare e shitblerjeve është 80638 lekë/m² dhe 71141 lekë/m² për këtë lloj pasurie e ndodhur në ZK 8514; lloji i pasurisë Njësi të ndodhura në ZK 8512 është 93364 lekë/m² dhe 12836 lekë/m² e ndodhur në ZK 8514; lloji i pasurisë Garazh/Bodrum e ndodhur në ZK 8512 është 49541 lekë/m² dhe 46785 lekë/m² e ndodhur në ZK 8514.

Aktualisht projekti prek 99 pasuri pronë private, ku përfshihen dhe ato pasuri që janë me gjendje juridike Pronar i Pavërtetuar, të cilat sipas ligjit kërkohet të shpërblehen për pronën që shpronësohet kur të kenë sistemuar dokumentacionin sipas ligjit nr. 111 “Për Kadastrën”, e administruar në ASHK, Drejtoria Vendore Durrës.

Vlera e shpronësimit 467 227 937 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë shtatë) lekë.

Vlera e shpronësimit do të përballohet nga Buxheti i Shtetit, i cili do të sigurohet nëpërmjet fondit të veçantë për shpronësimin për projektin “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës”, të alokuar pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim.

Shpronësimi për interes publik bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 41, dhe dhe në ligjin e posaçëm të shpronësimit, që mban nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin



dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, ku Neni 2 përcakton se: “... E drejta e shpronësimit dhe e marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private ushtrohet për një interes publik, që nuk mund të realizohet ose të mbrohet në mënyrë tjetër, veçse për shkaqe dhe në respektim të procedurave të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, në atë masë sa është e domosdoshme për realizimin e qëllimit të shpronësimit dhe në çdo rast kundrejt një shpërblimi të drejtë...” Neni 4 përcakton se: “... Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private bëhet duke respektuar dhe kompensuar në vlerë, në përputhje me ligjin, të drejtat e të tretëve mbi pasuritë pronë private që shpronësohen, si dhe zhvlerësimin për shkak të shpronësimit të pasurive të tjera pronë private që nuk janë objekt i shpronësimit...”. Neni 8: “Shkaku i shpronësimit” përcakton se: “Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për këto shkaqe: “ ... Për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut...”.

Grupi i punës, bazuar në verifikimin në terren, ballafaquar me projektin e miratuar, informacionit të marrë nga Asig Gjeoportal për pasuritë që preken nga investimi, si dhe informacionin si për pronarët e këtyre pasurive, si dhe çmimin e tokës “truall” për metër katror, çmimit mesatar të shitblerjeve të tre muajve të fundit të Ndërtesës së llojit Apartament, Njësi. Garazh/Bodrum), e marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, nëpërmjet sistemit elektronik që mban datën 14.11.2024 hartoi listën paraprake të pronarëve që shpronësohen për interes publik nga projekti “TID” Durrës, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik të Durrësit.

Grupi i punës vendosi që në listën e pasurive që preken nga ky investim të pasqyrohen në listën e shpronësimit dhe pasuritë me gjendje juridike Pronar i Pa Vërtetuar sipas pasqyrimit në kartelën e pasurisë. Nëse në të ardhmen do të rezultojë se Pronari i Pavërtetuar do të provojë pronësinë e konfirmuar kjo nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës do të kërkohet pasqyrimi i gjendjes në listën emërore për shpronësim. Nëse do të ndodhemi para faktit se është miratuar VKM-ja për shpronësim dhe sipas dokumentacionit të ardhur nga ASHK Durrës për pronësinë e pasqyruar si Pronar i Pa Vërtetuar do të kërkohet ndryshim i VKM-së dhe pronarit nuk do ti humbas e drejta për tu shpërblyer për pronën e prekur nga investimi i bashkisë.

Gjithashtu grupi i punës ka pasqyruar në listën për shpronësim dhe pasuritë me gjendje juridike Shtet. Vlera e shpronësimit për këto pasuri është pasqyruar me vlerën 0 (zero). Ky pasqyrim ka për qëllim rakordimin me institucionet shtetërore, që i kanë në pronësi apo në administrim këto pasuri, që të reflektojnë dhe pasqyrojnë në regjistrat përkatëse e krijuara për pasuritë e paluajtshme gjendjen në kontabilitetin sipas gjendjes në fakt (pas miratimit të VKM-së).

Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 467 227 937 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë shtatë) lekë e përlogaritur nga grupi i punës, e pasyruar në Dokumentin me emertimin “Lista emërore paraprake për shpronësimin, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës”, do të përballohet nga Fondet për financimin e projektit të Qeverisë Shqiptare, kjo në zbatim të prioritetëve të Programit të Qeverisë “Shqipëria 2023” miratuar me Vendim nr. 68/2021 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të




Këshillit të Ministrave”, Seksioni Kultura për “Përfundimin e Projektit të Rijetëzimit të Amfiteatrit të Durrësit”.

Pjesë e këtij relacioni janë dhe aktet e mëposhtme:

1. Urdhri nr. 310, datë 06.9.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga investimi që do të realizohet në zbatim të marrëveshjes nr. 7773/1 prot., datë 02.10.2023 lidhur ndërmjet AADF, Ministria e Kulturës dhe Bashkisë Durrës”, i ndryshuar me Urdhër nr. 427, datë 08.11.2024.
2. Marrëveshje nr. 7773/1 prot., datë 02.10.2023, lidhur ndërmjet AADF, Ministria e Kulturës dhe Bashkisë Durrës”, i ndryshuar.
3. Shkresa nr. 4215/2 prot., datë 05.12.2024 dalë nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, e protokolluar në Bashki me nr. 9073/7, datë 06.12.2024, datë 06.12.2024, me lëndë: “Dërgohet Vendimi nr. 07, datë 02.4.2024 “Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me vendodhje në Durrës””.
4. Vendim nr. 07, datë 02.4.2024 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës””.
5. Harta e Planvendosjes së Strukturave, e sigluar nga Kryetari i KKT-së dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
6. Marrëveshje për delegimin e Kompetencave, e sigluar nga kryetari i KKT-së dhe Kryetari i Bashkisë Durrës.
7. Përgjigje ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, në rrugë elektronike më email zyrtar, nënshkruar elektronikisht datë 14.11.2024, ku i përgjigjet kërkesës sonë për informacion për çmimet e tre muajve të fundit për disa lloje pasurish si Apartament; Njësi; Garazh/Bodrum.
8. Harta e vlerës së pasurisë së llojit Truall për ZK 8512 dhe 8514, miratuar me VKM-në nr. 89/2016.
9. Vlerësimi paraprak i pasurive, prone private qe preken nga projekti, i hartuar nga grupi i punës.

PUNUAN GRUPI I PUNËS:

znj. Alneida Rroshi (kryetar)



znj. Bianka Madhi (anëtar)



z. Aleks Prenga (anëtar)



z. Alvaro Kaçupi (anëtar)



z. Enli Kaçuli (anëtar)



znj. Danjela Gjinika (anëtar)





BASHKIA DURRES
20.12.24 N. 14274/13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. 758/prot.

Durrës, më 20.12.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRES

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.110 datë 16.12.2024, "Për miratimin e vlerës paraprake të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rjetëzimit të zonës arkeologjike "TID Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

